

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Të dhënat - Kostoja e një foshnje në Shqipëri, sa 66% e pagës mesatare vjetore, e dyta më e shtrenjtë në Europë
ADRESA	https://www.syri.net/ekonomi/917990/kostoja-e-nje-foshnje-ne-shqiperi-sa-66-e-pages-mesa-tare-vjetore-e-dyta-me-e-shtrenjte-ne-europe/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 13:21:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 13:00:01 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d86b212070f05a90dc09a5fed67eb13104a2540858166f0608756d3fb00b318a
TEKSTI	5d5600a3fb6698afe1d6e7e572cee0be84915f6574afd83875d72daf8828ba52
PAMJA	2cb9b74b791ef0c4b1f9c31806d21a7250aa4085cff50e04fd9357e38f4b66bb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	da8e548eeaf2387fa4f6ef6b5aaf2d19636fe62ac5ac7ffc3ead32c47ac45bf7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9767af9aea99dbf2ca0400fc3d10892444ae0e1100c3c88a0d864d11255bea91
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/da8e548eeaf2387fa4f6ef6b5aaf2d19636fe62ac5ac7ffc3ead32c47ac45bf7>


PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ENVER ROBELLI**
Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshtja e Tiranës**NDRIÇIM KULLA**
Rama dhe Vuçiç, dy vëllezërit
siamezë të dekadencës
demokratike evropiane


How much of the average annual wage goes to baby essentials in the first year?



Kostoja e një foshnje në Shqipëri, sa 66% e pagës mesatare vjetore, e dyta më e shtrenjtë në Europë

15:00, 20/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Të rrisësh një foshnjë në Shqipëri rezultojnë veçanërisht e kushtueshme, si në vlerë absolute, ashtu edhe në raport me të ardhurat. Sipas një përlogaritjeje të Remitly, produktet bazë për vitin e parë të jetës kushtojnë rreth 5,532 euro, shumë që përfaqëson rreth 66% të pagës mesatare vjetore. Të dhënat u publikuan nga Euronews.

Me këtë peshë, Shqipëria renditet e dyta më e shtrenjtë në Europë në raport me pagën mesatare, pas Moldavisë, ku kostoja arrin në 88.8% të pagës vjetore. Mesatarja për 36 vendet e analizuar është vetëm 20.9%.

Edhe në vlerë nominale, Shqipëria është ndër vendet më të shtrenjta. Me një kosto prej 5,532 eurosh për produktet bazë të foshnjës, ajo renditet e nënta më e shtrenjtë mes 38 vendeve evropiane të analizuar. Përpara saj janë Spanja, Holanda, Finlanda, Suedia, Zvicra, Luksemburgu, Italia dhe Lituania.

Por dallimi është se vendet që e paraprijnë Shqipërinë në këtë renditje kanë nivele pagash dhe të ardhurash dukshëm më të larta. Për këtë arsye, e njëjta faturë për një foshnjë përbën një pjesë shumë më të vogël të të ardhurave të familjeve në shumicën e këtyre vendeve. Në Zvicër, për shembull, produktet bazë përbëjnë vetëm 8% të pagës mesatare vjetore, në Holandë 9.4%, ndërsa në Shqipëri arrijnë në 66%.

Euronews: Kostoja e të pasurit një fëmijë në Europë: Ku janë më të lira produktet bazë?

Produktet bazë për një foshnjë mund të kushtojnë shumë më tepër në disa vende evropiane se në të tjera. Kur krahasohen me pagat mesatare, shpenzimet për pelena, ushqim dhe veshje mund të përbëjnë një barrë të rëndë financiare për prindërit, shkruan Euronews, që ka përpunuar të dhënat e Remitly.

Shumica e prindërve e përshkruajnë ardhjen në jetë të një fëmije si një nga momentet më të lumtura të jetës, por ajo shoqërohet edhe me kosto. Nga pelenat dhe ushqimi të karrocave dhe veshjet, lista e produkteve të nevojshme për një foshnjë është e gjatë. Dhe fatura mund të rezultojë më e lartë nga sa presin shumë prindër.

Kostoja e produkteve bazë për foshnjat ndryshon ndjeshëm në Europë. Por sa

më të lexuarat

Pse bankat evropiane po e heqin arin e tyre nga SHBA-ja?

Mali i Zi dyfishon pagat duke nisur nga janari, Edi Rama dyfishon çmimet

Bordi cakton çmimet e e reja: Nafta do shitet me 219 lekë dhe benzina me 195 lekë

Shpopullimi masiv/ Ikin të rinjtë, dyfishohet numri i pensionistëve të punësuar

BB: Shqipëria shpenzon mbi nivelin e nevojshëm për ujë e kanalizime, por nuk ka ujë

Thellohet kriza e prodhimit në Shqipëri/ Fasoni në rënie të pandalshme, zbrit në grupin e dytë

Kostoja e prodhimit të këmbimeve për foshnjë në raport me pagën mesatare?
shpenzojnë realisht prindërit? Cilat vende janë më të shtrenjtat dhe ku këto produkte janë më të përballueshme në raport me pagat mesatare?

Remitly ka llogaritur koston vjetore të produkteve bazë gjatë vitit të parë të jetës së një fëmije, bazuar në çmimet e korrikut 2026. Përlogaritja përfshin 14 produkte bazë, të ndara në gjashtë kategori:

Ndërrimi i pelenave: pelena, peceta të lagura dhe krem kundër irritimit;

Shishe për ushqyerjen, së bashku me kapakët;

Qumësht formule për foshnjat;

Gjumi: krevat, shportë portative ose krevat tip "Moses", dyshek, çarçafë me llastik dhe batanije;

Transporti: ndenjës makine për foshnja dhe karrocë;

Veshje: trupa për foshnja, complete ose pantallona dhe çorape.

Në 38 vende europiane, kostoja e vlerësuar e produkteve bazë gjatë vitit të parë varion nga 2,813 euro në Mbretërinë e Bashkuar në 6,294 euro në Spanjë, ndërsa mesatarja europiane është 4,727 euro.

Përveç Spanjës, shpenzimet për vitin e parë kalojnë 6,000 euro edhe në Holandë, me 6,140 euro, Finlandë, me 6,066 euro, Suedi, me 6,025 euro, dhe Zvicër, me 6,018 euro.

Kostot janë midis 5,000 dhe 6,000 eurove në Luksemburg, me 5,665 euro, Itali, 5,609 euro, Lituani, 5,563 euro, Shqipëri, 5,532 euro, Serbi, 5,509 euro, Mal të Zi, 5,500 euro, Portugali, 5,337 euro, Sllovaki, 5,221 euro, Norvegji, 5,079 euro, dhe Islandë, 5,004 euro.

Mes pesë ekonomive më të mëdha, Spanja ka kostot më të larta, ndërsa Mbretëria e Bashkuar më të ulëta, me 2,813 euro. Gjermania, me 4,701 euro, dhe Franca, me 4,393 euro, janë më pranë mesatares europiane.

Prindërit në Çeki, me 3,211 euro, Rumani, 3,385 euro, Letoni, 3,392 euro, Kroaci, 3,661 euro, Bullgari, 3,804 euro, dhe Bosnjë-Hercegovinë, 3,844 euro, përballen me disa nga kostot më të ulëta në vlerë nominale. Në të gjashta vendet, shpenzimet janë nën 4,000 euro.

Turqia, me 4,023 euro, Belgjika, me 4,084 euro, Malta, me 4,118 euro, dhe Greqia, me 4,158 euro, janë gjithashtu pranë nivelit 4,000 euro, por pak mbi të.

Shpenzimet më të mëdha për veshje, qumësht formule dhe pelena

Shpërndarja e kostove mes gjashtë kategorive ndryshon shumë nga një vend europian në tjetrin. Mesatarisht, veshjet përbëjnë 30.3% të totalit, qumështi formulë 25.7% dhe pelenat 24.5%. Së bashku, këto tri kategori zënë 81% të shpenzimeve totale gjatë vitit të parë.

Në 38 vendet e analizuara, prindërit shpenzojnë mesatarisht 1,465 euro për veshje, 1,187 euro për qumësht formule dhe 1,152 euro për pelena, duke e çuar koston e përbashkët të këtyre tri kategorive në 3,804 euro.

Struktura e shpenzimeve ndryshon ndjeshëm nga vendi në vend. Veshjet përbëjnë vetëm 16% të koston në Danimarkë, kundrejt 52.5% në Suedi. Pesha e tyre kalon 45% edhe në Holandë, Finlandë dhe Irlandë.

Qumështi formulë përbën 10.8% të shpenzimeve në Suedi, por arrin në 41.3% në Letoni. Pesha e tij është e lartë edhe në Turqi, Danimarkë dhe Hungari, ku kalon 35%.

Pelenat përbëjnë 12.4% të koston në Turqi, ndërsa në Zvicër dhe Belgjikë zënë më shumë se 36%.

Kostoja e foshnjës në raport me pagën mesatare

Natyrisht, nivelet e të ardhurave kanë rëndësi kur krahasohen vendet, për shkak të diferencave të mëdha të pagave në Europë. Pra, sa për qind e pagës mesatare vjetore shkon për produktet bazë të foshnjës gjatë vitit të parë?

Studimi i Remitly ka krahasuar koston e produkteve bazë për foshnjat me pagat mesatare në secilin vend. Për këtë qëllim janë përdorur të dhënat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për të ardhurat mesatare mujore të punonjësve, të përshtatura me inflacionin.

Përballueshmëria varet gjithashtu nga fakti nëse punojnë të dy prindërit, si edhe nga taksat dhe përfitimet familjare. Këto elemente mund të krijojnë diferenca të ndjeshme mes vendeve.

Këmbimi valutë 20 shtator/ Me sa blihen e shiten dollari dhe euro, çfarë ndodh me monedhat e tjera

'Taksë e fshehtë' mbi naftën për rezervën e sigurisë, do të rritet çmimi, e pranon dhe qeveria

Kostoja e një foshnje në Shqipëri, sa 66% e pagës mesatare vjetore, e dyta më e shtrenjtë në Europë

Në 36 vendet e përfshira në këtë krahasim, produktet bazë për një foshnjë kushtojnë mesatarisht 20.9% të pagës vjetore. Pesha varion nga vetëm 5.4% në Belgjikë deri në 88.8% në Moldavi.

Sipas kësaj përllogaritjeje, prindërit në Shqipëri shpenzojnë për produktet bazë të vitit të parë rreth 66% të pagës mesatare vjetore. Pas Shqipërisë renditen Turqia, me 45.1%, Mali i Zi, me 45%, Serbia, me 41.4%, Bosnjë-Hercegovina, me 36.1%, Portugalia, me 35.7%, dhe Hungaria, me 34.7%.

Në të gjitha këto vende, shpenzimet për produktet e foshnjës përbëjnë të paktën një të tretën e pagës mesatare vjetore.

Në anën tjetër, këto shpenzime përbëjnë më pak se 10% të pagës mesatare vjetore në Luksemburg, me 6%, Danimarkë, 6.7%, Mbretërinë e Bashkuar, 7.5%, Norvegji, 7.6%, Irlandë, 8%, Zvicër, 8%, Gjermani, 8.1%, Austri, 8.2%, Francë, 8.5%, Maltë, 8.9%, dhe Holandë, 9.4%.

Po çerdhet dhe kujdesi për fëmijët?


Studimi nuk përfshin kostot e çerdheve dhe shërbimeve të tjera të kujdesit për fëmijët, të cilat mund të përbëjnë një barrë të konsiderueshme shtesë për prindërit në Europë.


Për shembull, në vitin 2023, tarifat bruto të kujdesit për dy fëmijë arritën në 64,211 euro në Zvicër, ndërsa Holanda kishte nivelin më të lartë në Bashkimin Europian, me 39,229 euro, sipas OECD-së. Në Gjermani, shifra ishte vetëm 552 euro.

Këto të dhëna i referohen kujdesit të organizuar në qendra, pra shërbimeve të ofruara jashtë shtëpisë në institucione të licencuara. Këtu përfshihen çerdhet, qendrat ditore, institucionet parashkollore dhe grupet e organizuara nga prindërit, me kohë të plotë ose të pjesshme.

Kur merren në konsideratë kostot neto të kujdesit për dy fëmijë, shifra është 10,200 euro për një familje me vetëm një të ardhur në Zvicër dhe 27,551 euro për një çift ku punojnë të dy prindërit.

Megjithatë, mbështetja nga shteti mund t'i ulë ndjeshëm këto kosto në disa vende, duke i çuar shpenzimet neto nën 5,000 euro./ Euronews





© SYRI.net

Lexo edhe:



Këmbimi valutor 20 shtator/ Me sa blihen e shiten dollari dhe euro, çfarë ndodh me monedhat e tjera



Bordi cakton çmimet e e reja: Nafta do shitet me 219 lekë dhe benzina me 195 lekë



Çfarë po ndodh me monedhat e huaja? Ja sa shitet dhe blihet euro dhe dollari

TË NGJASHME



Mali i Zi dyfishon pagat duke nisur nga janari, Edi Rama dyfishon çmimet



Pse bankat evropiane po e heqin arin e tyre nga SHBA-ja?



Këmbimi valutor sot - Ja me sa blihen e shiten dollari dhe euro, si luhaten monedhat e tjera



Gati gjysma e shqiptarëve kanë vështirësi të mbyllin muajin



'Taksë e fshehtë' mbi naftën për rezervën e sigurisë, do të rritet çmimi, e pranon dhe qeveria



Thellohet kriza e prodhimit në Shqipëri/ Fasoni në rënie të pandalshme, zbret në grupin e dytë



Shpopullimi masiv/ Ikin të rinjtë, dyfishohet numri i pensionistëve të punësuar

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.